



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OST/OT-së

Përgjigje ndaj Komenteve

Periudha e Tretë Rregullative (2023 – 2027)

DEKLARATË

Ky Dokument është përgatitur me qëllim të informimit të palëve të interesit gjatë procesit të konsultimit publik. Dokumenti duhet të lexohet krahas Raportit Konsultativ të ZRRE-së të publikuar më 16 shkurt 2023. Dokumenti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

23 mars 2023

Përmbajtja

Tabela e shkurtesave	3
1. Hyrje	4
2. Komentet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	5
2.1 Ndryshimi i çmimit të energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim	5
2.1.1 Komentet e KEK	5
2.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	5
3. Çmimi referent për BRE	5
4. Komentet nga Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT)	6
4.1 Kostot e shërbimeve ndihmëse	6
4.1.1 Komentet e KOSTT	6
4.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	6
4.2 Mekanizmi ITC	6
4.2.1 Komentet e KOSTT	6
4.2.2 Përgjigjja e ZRRE-së	6
4.3 Kostot e humbjeve	7
4.3.1 Komentet e KOSTT	7
4.3.2 Përgjigjja e ZRRE-së	7
4.4 Kostot e shpenzimeve tjera operative	7
4.4.1 Komentet e KOSTT	7
4.4.2 Përgjigjja e ZRRE-së	7
4.5 Kostot kapitale 2023-2028	7
4.5.1 Komentet e KOSTT	7
4.5.2 Përgjigjja e ZRRE-së	7
5. Përmbledhje e MAR të OST/OT (KOSTT)	8

Tabela e shkurtesave

Shkurtesat e përdorura në këtë dokument kanë këtë kuptim:

CPI	Consumer Price Index
EEX	European Energy Exchange
EUROSTAT	European Statistical Office
FSHU	Furnizuesi i Shërbimit Universal
HLM/MAR	Të Hyrat e Lejuara Maksimale
KEDS	Kompania Kosovare e Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike
KEK	Korporate Energjetike e Kosovës
KESCO	Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut i Kosovës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MWh	Megavat orë
OPEX	Operational Expenditure- Shpenzimet Operative
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST/OT	Operatori i Sistemit, Transmisionit , Operatori i Tregut
PRR 3	Periudha e Tretë Rregullative
ZPRK	Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovë
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

1. Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit Periodik për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR 3), e cila përfshinë përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) për periudhën 2023-2027. Shqyrtimi Periodik do të përcaktojë të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit, të Transmisionit dhe Tregut (OST/OT-KOSTT sh.a) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS sh.a).

Pas vlerësimit fillestar të Aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për të licencuarin e Operatorit të Sistemit, të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

Ky dokument paraqet përgjigjet në komentet e bëra nga palët e interesuara, dhe propozimin e ZRRE-së lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së.

Lidhur me vlerësimin fillestar të të Hyrave të Lejuara Maksimale të OST/OT-së, ZRRE ka pranuar komente nga i licencuari (KOSTT) si dhe nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

Komentet e pranuar nga palët e interesit janë publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së. Në këtë pjesë të Dokumentit japim një përmbledhje e këtyre komenteve si dhe përgjigjet e ZRRE-së mbi to.

2. Komentet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

2.1 Ndryshimi i çmimit të energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim

2.1.1 Komentet e KEK

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) thekson se marrëveshja aktuale për çmime me palët KEDS, KESCO dhe KOSTT skadon me datën 31.03.2023. Për shkak të ndryshimeve në kostot e eksploatimit të thëngjillit, prodhimit të energjisë elektrike nga Termocentralet si dhe nga rritja e tarifave të KOSTT, KEK kërkon nga palët që të marrin parasysh çmimet e rishikuara nga KEK për periudhën 01.04.2023 – 31.03.2024 siç vijojnë:

- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e Furnizimit për Shërbim Universal – 32.40 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në shpërndarje – 39.54 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në transmetim – 39.54 €/MWh;

2.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së

Duhet të theksohet se me ndryshimet ligjore që rregullojnë sektorin e energjisë të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2016, ZRRE ka amandamentuar legjislacionin sekondar për të qenë në harmoni me legjislacionin primar, prandaj në këtë kuptim çmimet e prodhimit për gjeneratorin publik KEK nuk rregullohen nga ZRRE që nga viti 2017, por ato i nënshtrohen kushteve të tregut. Çmimi për të cilin palët tregtare mund të arrijnë pajtimin ndërmjet tyre duhet të jetë në pajtim me Procedurën për Tregtimin e Energjisë, Rregullat e Tregut dhe kërkesat tjera të legjislacionit sekondar.

ZRRE deri me tani nuk ka pranuar ndonjë kërkesë ndryshe nga palët të Hyrat e Lejuara Maksimale të të cilave i nënshtrohen rregullimit. Prandaj, në vlerësimin e kostove me shumicë për vitin 2023, ZRRE ka marrë në konsideratë propozimet e palëve që bazohen në çmimet aktuale. Sidoqoftë, palët duhet të respektojnë parimet e sipërpërmendura në azhurnimet e çmimeve me shumicë në të ardhmen.

3. Çmimi referent për BRE

Sipas metodologjisë tarifore për llogaritjen e çmimit referent, ZRRE përcakton çmimin referent për BRE, i cili aplikohet nga Operatori i Tregut për energjinë e shitur tek furnizuesit. I njëjti çmim do të aplikohet edhe për shitblerjen e energjisë nga BRE sipas kornizës së rregulluar.

Çmimi referent i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, i cili do të aplikohet për vitin relevant tarifar 2023 rezulton të jetë 55.87 Euro/MWh.

4. Komentet nga Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT)

4.1 Kostot e shërbimeve ndihmëse

4.1.1 Komentet e KOSTT

Nga data 1 Prill 2021 kur kapacitetet blihen në ankand nga OST, ato rriten me çmimet e ankandit në vlerat mesatare rreth 17 €/MWh gjatë vitit 2021, ndërsa në vitin 2022 kjo vlerë sillet mesatarisht rreth 20 €/MWh. Duke e parë këtë trend të rritjes, vlera për Koston e Shërbimeve Ndhmese për vitet 2023 e tutje duhet të rritet në vlerat e parashikuara sipas KOSTT. Kërkesa e KOSTT për vitin 2023 për Shërbimet Ndhmëse është 13mil€.

4.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së

ZRRE në parim njih të gjitha kostot e arsyeshme të KOSTT ashtu që të mund të kryej të gjitha funksionet e operimit si zonë e pavarur. Në këtë kuptim, ZRRE në parim njih të gjitha kostot e shërbimeve ndihmëse, mirëpo duke qenë se edhe në vitet paraprake ka pasur dallime ndërmjet parashikimit dhe realizimit të kostove për këto shërbime, ZRRE ashtu si në propozimin fillestar, propozon që kostot për shërbime ndihmëse të jenë sa mesatarja e realizuar në dy vitet e fundit. Ky propozim bazohet në faktin se KOSTT edhe në vitet paraprake ka kontraktuar shërbimet ndihmëse, por jo gjithëherë kostot e realizuara kanë qenë sipas planeve, rrjedhimisht kostot e shkaktuara kanë qenë më të ulta se planifikimet. Prandaj, duke qenë se këto kosto janë subjekt i përshtatjeve, ZRRE nuk e sheh të arsyeshme të ndryshojë vlerësimin fillestar të këtyre kostove.

4.2 Mekanizmi ITC

4.2.1 Komentet e KOSTT

Të hyrat nga transiti janë paraqitur në kontinuitet prej 1,36mil€ për të gjithë periudhën 2023-2027, që është vlerë shumë e madhe se sa realizimi. Sa për krahasim gjeni në tabelën e mëposhtme të hyrat neto (parashenja +) dhe shpenzimet e netuara (parashenja -) nga transiti sipas viteve:

Tabela 1. Të hyrat nga ITC 2016 - 2022

Vitet	Neto te Hyrat nga ITC (2016 – 2022)
2016	€ + 225,257.26
2017	€ + 68,702.59
2018	€ + 1,035,974.62
2019	€ + 499,464.83
2020	€ - 28,128.59
2021	€ +168,768.45
2022 (të dhëna preliminare deri në qershor 2022)	€ - 640,746.77

4.2.2 Përgjigjja e ZRRE-së

ZRRE ka rishikuar te hyrat e planifikuar nga ITC, dhe ka korrigjuar parashikimet ne 207 mije euro, që paraqet mesataren e realizuar në periudhën 2018-2022.

4.3 Kostot e humbjeve

4.3.1 Komentet e KOSTT

Kostot e Humbjeve në Transmision për vitin 2022 kanë qenë 14,889.462 €. Vlera e Raportuar në Formularët Raportues të dërguar në ZRRE me datë 22 Nëntor 2022 prej 13,257,705 €, ka qenë vlerë e realizuar për dhjetë muaj dhe dy muaj planifikim.

4.3.2 Përgjigjja e ZRRE-së

ZRRE pas pranimit të informatave të fundit nga KOSTT, ka analizuar blerjet e energjisë për mbulimin e humbjeve në OST. Në bazë të të dhënave, kostoja prej 14.9mil€ përshinë edhe kostot për mbulimin e humbjeve në katër komunat veri, prandaj për të kalkuluar çmimin mestar për blerje të humbjeve në OST që duhet të reflektohet të tarifata e rregulluara të OST-së, ZRRE ka përjashtuar kostot që kanë të bëjnë me furnizimin e veriut, si rezultat çmimi mestar për mbulimin e humbjeve në OST mbetet i njëjtë sikurse në propozimin fillestar.

4.4 Kostot e shpenzimeve tjera operative

4.4.1 Komentet e KOSTT

Bazuar në planin investiv për periudhën tarifore 2023-2028 do të funksionalizohen edhe 4 nënstacione të reja për të cilat sipas sistematizimit aktual duhet të punësohen nga 4 punëtorë për secilin nënstacion, me ç'rast do të ndikojnë në rritjen e numrit të punëtorëve nga viti 2024.

Ndërlidhur me rritjen e stafit sipas realizimit nga Planit investiv 2023-2027 propozoj që ZRRE të rishikoj mundësinë e rritjes së shpenzimeve tjera operative nga viti 2024 prej 5 - 6 % sipas tabelës.

4.4.2 Përgjigjja e ZRRE-së

ZRRE ka përshtat kostot e OS për të adresuar nevojat shtesë të personelit në vlerësimin fillestar në vlerë prej 50 mijë euro ashtu që KOSTT të mund të kryejë me përgjegjësi aktivitetet shtesë në operimin e saj si zonë e pavarura. Prandaj, OPEX i OS-së mbetet i pandryshuar krahasuar me vlerësimin fillestar.

4.5 Kostot kapitale 2023-2028

4.5.1 Komentet e KOSTT

KOSTT në vitin në Planin Investiv 2023-2028 ka paraparë një vijë buxhetore prej 160,000 euro për projektin me ID 061: Përmirësimi i Izolimit të Anës 220 kV në NS Kosova A. Pasi vlera e paraparë në vitin 2022 prej 160,000 euro nuk ka arritur të kontraktohet dhe ka dështuar si vije buxhetore kërkojmë që vlera e parapare në planin investiv 2023-2028 të rritet për të njëjtën vlerë, pra edhe për 160,000 dhe në total të jetë në vlerë prej 320,000 euro.

4.5.2 Përgjigjja e ZRRE-së

ZRRE ka pranuar komentin e KOSTT dhe ka azhurnuar investimet kapitale për projektin e kërkuar nga KOSTT. Si rezultat të këtij ndryshimi, janë përshtatur edhe kostot e zhvlerësimit dhe kthimit që derivojnë nga projekti kapital.

5. Përmbledhje e MAR të OST/OT (KOSTT)

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave në dispozicion dhe atyre të paraqitura nga palët e përfshira në proces, si dhe pas komenteve të pranuar nga KOSTT gjatë konsultimit publik, duke marrë në konsideratë edhe vendimet e Bordit të ZRRE-së për vlerat hyrëse për PRR3, vlerësimi dhe propozimi përfundimtar i ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) për periudhën e tretë rregullative 2023-2027 është si më poshtë:

Propozimi i ZRRE-së për HLM €000s	PRR3				
	2023	2024	2025	2026	2027
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)					
Baza Opex	5,923	5,835	5,749	5,664	5,581
Zhvlerësimi	11,061	11,465	11,855	12,624	12,978
Kthimi i Lejuar	9,307	9,617	9,787	10,105	10,227
Të hyrat jo-tarifore- alokimi i kapaciteteve	-8,310	-8,310	-8,310	-8,310	-8,310
ITC	-207	-207	-207	-207	-207
Përshtatjet Capex- PRR2	-1,963	-1,963	-1,963	-1,963	-1,963
Përshtatjet PRR2 dhe vitit 2022	-2,077	-2,077	-2,077	-2,077	-2,077
Totali	13,734	14,360	14,834	15,837	16,229
Operatori i Sistemit (OS)					
Baza Opex	1,716	1,691	1,666	1,641	1,616
Kosto e Humbjeve	13,308	13,308	13,308	13,308	13,308
Kostot e Shërbimeve Ndhmëse	8,638	8,638	8,638	8,638	8,638
Zhvlerësimi	1,879	2,391	2,290	1,420	1,571
Kthimi i Lejuar	556	823	888	875	871
Të hyrat jo-tarifore	-	-	-	-	-
Përshtatjet CAPEX PRR2	-425	-425	-425	-425	-425
Përshtatjet PRR2 dhe vitit 2022	-946	-946	-946	-946	-946
Totali	24,727	25,481	25,420	24,512	24,634
Operatori i Tregut (OT)					
Baza Opex	256	252	249	245	242
Zhvlerësimi	0	0	0	28	56
Kthimi i Lejuar	62	45	29	22	20
Fondi i burimeve të ripërtitshme	20,929	20,929	20,929	20,929	20,929
Përshtatja e fondit të BRE-ve për vitin 2022	-4,464				
Përshtatjet për PRR2	-5.2	-5.2	-5.2	-5.2	-5.2
Përshtatjet PRR2 dhe vitit 2022	-5.9	-5.9	-5.9	-5.9	-5.9
Totali	16,772	21,215	21,195	21,212	21,235
HLM KOSTT	55,234	61,056	61,449	61,561	62,098

Siç është theksuar në vazhdimësi, komponentët e kostove të të Hyrave të Lejuara Maksimale përshtaten në baza vjetore sipas dispozitave të parapara në rregullat e të hyrave me qëllim të reflektimit të kostove të arsyeshme të shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike për vitin përkatës.